



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR
për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016
“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

Nr. 10 Prot.

Tiranë, më 25.01.2019

Lënda: Dërgohet raporti mbi “Masat e nevojshme dhe disa rekomandime në funksion të sigurimit të vazhdimësisë së veprimtarisë inspektuese në konsiderim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

Z. ULSI MANJA
KRYETAR I KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

I nderuar z. Manja,

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, në mbështetje dhe në zbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 288 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, mori në shqyrtim shkresën Nr.3561 Prot., datë 13.12.2018, të dërguar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet së cilës kërkohet mendim dhe ndërmarrja e masave të përshtatshme për të siguruar vazhdimësinë institucionale dhe për të shmangur vakumin në procesin e hetimit disiplinor të gjyqtarëve.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe të të gjitha referencave ligjore të nevojshme për analizën e rastit, me vendim nr.9, datë 25.01.2019 miratoi raportin “Mbi masat e nevojshme dhe disa rekomandime në funksion të sigurimit të vazhdimësisë së veprimtarisë inspektuese në konsiderim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Bashkëlidhur kësaj shkrese lutem gjeni kopje të raportit.

ARTAN SPAHIU

KRYETAR



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

**KOMISIONI I PAVARUR
për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016
“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”**

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në mbledhjen e datës 25.01.2019, pas propozimit të Kryetarit të Komisionit të Pavarur si dhe pas diskutimeve, miraton me 5 vota pro dhe asnjë kundër, Raportin si më poshtë:

R A P O R T

MBI

**MASAT E NEVOJSHME DHE DISA REKOMANDIME NË FUNKSION TË
SIGURIMIT TË VAZHDIMËSISË SË VEPRIMTARISË INSPEKTUESE
në konsiderim të Ligjit nr.115/2016
“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”**

BAZA LIGJORE:

- Nenet 288, i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- Vendimi i Kuvendit nr.74/2018 “Për ngritjen e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”;
- Rregullore e Komisionit të Pavarur, të miratuar me Vendimin e Komisionit nr.3 datë 09.11.2018, e ndryshuar.

ANALIZA MBËSHTETET NË NENET:

- Neni 277 dhe 283 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- Neni 3, pika 10 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Nenet 160, (pika 1 dhe 5), 168/3 si dhe 171, (pika 2) të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni i Pavarur mori për shqyrtim shkresën Nr.3561 Prot. datë 13.12.2018, të dërguar nga Kryeinspektorja e Inspektoriatit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me anë të të cilës kërkohet mendim për mënyrën e zgjidhjes së problemit të inspektoriatit pranë KLD, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së procesit të hetimit disiplinor të gjyqtarëve.

a. Arsyetimi i Komisionit të pavarur në lidhje me vazhdimësinë funksionale të Inspektorëve:

Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ka parashikuar inspektoratet ekzistuese si organe, të cilat do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetenca, ndër të cilat përfshiheshin:

- vendosja e masave disiplinore, me propozim të ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji;
- pezullimi i gjyqtarëve, sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj;
- mbikëqyrja e trajnimit të gjyqtarëve, sipas këtij ligji dhe ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- vlerësimi i punës, siç parashikohet në dispozitën kalimtare të këtij ligji, duke përfshirë edhe ndihmën në rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- marrja e masave disiplinore për inspektorët, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.

Sa kohë që në këtë listë funksionesh, megjithë ngritjen e disa prej organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka ende të tilla që nuk i janë transferuar akoma ndonjë prej organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ato vazhdojnë të mbeten funksion i inspektorëve, për aq kohë sa nuk ka parashikim tjetër (deri dje pranë KLD).

Nga ana tjetër neni 168 (pikat 2 dhe 3) të ligjit të posaçëm, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, kanë parashikuar që:

2. Inspektori vazhdon të ushtrojë detyrën e tij, sipas mandatit të mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VII, të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Inspektorët në detyrë, sipas këtij neni, që janë caktuar kryesisht për kryerjen e hetimeve disiplinore, vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe konsiderohen si të komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kohën e krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Inspektorët në detyrë, të cilët janë caktuar kryesisht për kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional konsiderohen si të komanduar përkatësisht në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe përkatësisht në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke asistuar Këshillin në ushtrimin e funksionit për vlerësimin etik dhe profesional.

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 283, pikat 8, 9 dhe 10 ka parashikuar që:

- zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konsiderohet e krijuar ditën e parë të muajit që vjen pas emërimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi dhe
- Veprimtaria e inspektimit pushon në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ligji e ka lidhur pushimin e funksioneve, me krijimin e Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë, ndaj sa kohë kjo zyrë nuk është ngritur ende nuk mund të ketë dyshime për vazhdimësinë funksionale të detyres. Gjithashtu, legjislatori në dispozitat e sipërcituara, e lidh nga njëra anë ngritjen e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me emërimin nga Kuvendi të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nga ana tjetër, pushimin e zhvillimit të veprimtarisë inspektuese, me ngritjen e Zyrës së ILD-së.

